



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë më 27.10.2022

Dokument parlamentar

(Komision për dhënie mendimi)

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

(shqyrtimi në parim)

I. Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 27 tetor 2022, shqyrtoi dhe miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023”, i cili është propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Për shqyrtimin e këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatorë deputetët z. Klevis Xhoxhi dhe z. Saimir Hasalla.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin ishin znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë dhe znj. Adela Xhemali dhe znj. Vasilika Vjero zëvendësministre të Financave dhe Ekonomisë, znj. Mimoza Dhëmbi Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit dhe e Borxhit Publik dhe përfaqësues të tjerë të ministrisë.

Bazuar në vendimin e Konferencës së Kryetareve, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

II. Baza ligjore e projektligjit, vlerësimi kushtetues dhe procedural

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2023” është propozuar nga Këshilli i Ministrave, në bazë të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës. Ky projektligj i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

III. Objektivat e përgjithshme të buxhetit 2023

Projektligji parashikon tërësinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore e vendore si dhe të fondeve speciale (sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve) për vitin buxhetor 2023.

Objektiv madhor i projektbuxhetit 2023 është rimëkëmbja ekonomike, në vazhden e përpjekjeve për të tejkaluar me sukses periudhën e vështirë për ekonominë botërore dhe ekonominë shqiptare, si pjesë e pandarë e saj. Qeveria shqiptare nëpërmjet draftit të depozituar ka adresuar sfida të rëndësishme, si minimizimi i efekteve nga rritja e çmimeve të energjisë elektrike dhe rritja e çmimeve të konsumit. Nga ana tjetër, politika fiskale gjatë vitit 2023 do të orientohet drejt rritjes së qëndrueshmërisë ekonomike dhe uljes së stokut të borxhit publik për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Përtej situatës së vështirë që kaloi ekonomia shqiptare gjatë vitit aktual, është pozitiv fakti se deri më tani, ajo ka arritur t’i përballojë relativisht mirë pasojave të luftës në Ukrainë, duke rishikuar objektivin e rritjes ekonomike nga 3.2 në 3.7 %, duke mbajtur nën kontroll inflacionin, me norma që kanë rezultuar ndjeshëm më të ulëta se sa vendet e rajonit dhe se sa mesatarja e vendeve të BE-së si dhe duke subvencionuar çmimin e energjisë për të mbrojtur familjet shqiptare dhe bizneset e vogla dhe të mesme.

Qeveria ka alokuar paketa të ndryshme të ndihmës sociale për pjesët e shoqërisë më në nevojë siç janë fondet e kompensimit të energjisë elektrike për pensionistët dhe fondet për kompensimin pjesërisht të rritjeve në kostot kryesore për punimet e investimeve publike etj. Në shtator të këtij viti qeveria miratoi rritjen pensione në nivelin 6% dhe të pagave të administratës publike në nivelin 7%.

Projektbuxheti i vitit 2023, parashikon një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist për sa i përket rritjes ekonomike, deficitit buxhetor, borxhit publik dhe normës së papunësisë. Më specifikisht, për vitin 2023, parashikohet një ngadalësim i rritjes ekonomike në 2.6%, ndikuar nga

zhvillimet e ekonomisë globale, por pa shënuar vlera negative të saj. Rritja ekonomike do të mbështetet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të investimeve publike prej 5.2 % e PBB-së, duke u përqendruar në financimin e projekteve me rëndësi strategjike, që synojnë mbështetjen për dixhitalizimin dhe sigurinë kibernetike, finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, sigurinë kombëtare, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Deficiti buxhetor për vitin 2023 planifikohet të jetë në nivelin 2.6% të PBB nga rreth 3.3 % i pritshëm për vitin 2022. Gjithashtu, borxhi publik bruto do të vazhdojë trajektoren rënëse dhe për vitin 2023 në vlerën e parashikuar 67.5%, ndërsa brenda vitit 2025, borxhi parashikohet të arrijë në 65.4% të PBB-së.

Projektbuxhetit i vitit 2023, në përputhje dhe me programin ambicioz të Qeverisë është buxheti i mbështetjes financiare të mëtejshme të reformave të nisura në sektorët kyç të ekonomisë, si reforma në drejtësi, reforma e administratës publike dhe reforma e menaxhimit të financave publike.

Ky buxhet është konsideruar buxhet i rritjes së pagave për dy sektorët më të rëndësishëm në vend: të shëndetësisë dhe të arsimit me një rritje prej 6%, e llogaritur në vlerën 2.3 miliardë lekë.

Në vitin 2023, të ardhurat totale të buxhetit janë planifikuar të arrijnë në 625.7 miliardë lekë, ose 29% të PBB-së me një rritje prej 7.7% krahasuar me të pritshmin e vitit 2022. 94% të të ardhurave të planifikuara për tu mbledhur deri në fund të vitit 2023 janë nga zëri i të ardhurave tatimore, të cilat planifikohen në vlerën 587.8 miliardë lekë, ndërkohë, të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore planifikohen të jenë 126.5 miliardë lekë.

Për vitin 2023 shpenzimet e përgjithshme buxhetore janë programuar në nivelin e 687.2 miliardë lekë ose 31.6 % e PBB. Shpenzimet e personelit për vitin 2023, janë planifikuar në masën 96.8 miliardë lekë, 14,1 % të shpenzimeve buxhetore ose 4.5% e PBB-së. Këto shpenzime reflektojnë koston aktuale të Administratës Publike, si dhe politikën e re të rritjes së pagave kryesisht për sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes me një rritje prej 6%.

IV. Realizimi i reformave

A. Reforma në Drejtësi

Mbështetja financiare e reformës në drejtësi, e cila ka synim të përgjithshëm krijimin e një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, është prioritet dhe në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm.

Për reformën në drejtësi që prej vitit 2016 qeveria shqiptare ka shpenzuar rreth 45 miliardë lekë, një reformë shumë e rëndësishme, e cila do të ndihmojë në mënyrë të padiskutueshme edhe zhvillimin ekonomik afatmesëm. Në vitin 2022 reforma u mbështetet me 8.64 miliardë lekë dhe 179 personel shtesë për institucionet e drejtësisë, duke arritur në një numër total prej 3342 punonjësish. Ndërsa për vitin 2023 mbështetja buxhetore për të gjitha institucionet e drejtësisë është planifikuar të jetë rreth 9 miliard lekë, me një shtesë prej 400 milion lekë.

Rritjen më të madhe të shpenzimeve buxhetore në krahasim me vitin 2022, për institucionet e drejtësisë e ka SPAK me një rritje me 123 milion lekë, KLGJ me një rritje me 122 milion lekë, Prokuroria e Përgjithshme 85 milion lekë më shumë dhe organet e rivlerësimit kalimtar me 48 milion lekë.

Rritje të shpenzimeve buxhetore është planifikuar dhe për një sërë institucionesh të tjera të pavarura, kështu në projektbuxhet është parashikuar rritja e shpenzimeve buxhetore të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, secili me nga 11 milion lekë më shumë se në 2022 si dhe institucionit të Avokatit të Popullit me 10 milion lekë më shumë se në 2022.

Gjithashtu, rritje në krahasim me vitin 2022 janë planifikuar edhe në fondet e Ministrisë së Drejtësisë, ku parashikohet një buxhet total prej afërsisht 12 miliard lekë, ose 687 milion lekë më shumë se një vit më parë. Ky buxhet do të përmbushë më së miri objektivat e kësaj ministrie, të cilat janë orientuar jo vetëm drejt jetësisë të Reformës në Drejtësi dhe përmirësimit të kuadrit ligjor në këtë drejtim, por edhe drejt përmirësimit të sistemit të ndihmës juridike falas që çdo qytetar në pamundësi financiare dhe grupet në nevojë, reformimit të sistemit penitenciar në tërësi, përmirësimit të shërbimit të provës për monitorimin e zbatimit të dënimeve alternative.

Nëpërmjet buxhetit të akorduar për Ministrinë e Drejtësisë arrihet të garantohet:

- Rritja e pagave të Policisë së Burgjeve, mesatarisht me 18.66% dhe në nivelin bazë nga 16% deri në 34%.
- Financimi i projektit për ndërtimin e Institutit të Rehabilitimit të Miturve, në Mëzez, i cili synon të realizojë objektivin e kalimit të të miturve nga sistemi penitenciar në sistemin rehabilitues duke realizuar ri-shoqërizimin e të miturve dhe të rinjve, siç parashikohet në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe mbështetur në rekomandimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

Ministria e Drejtësisë për periudhën tre vjeçare në vijim synon:

- Ofrimin e ndihmës juridike falas në përshtatje dhe me hartën e re gjyqësore për 6,300 individë që plotësojnë kushtet në zbatim të ligjit për ndihmën juridike falas, nga të cilat 3700 gra e vajza në nevojë.
- Përmirësimin e kushteve në sistemin penitenciar dhe uljen e mbipopullimit në burgje dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme të rreth 5500 të dënuarve burra, 86 të dënuara gra dhe 36 të dënuar të mitur, si dhe të trajtimit me shërbim shëndetësor 382 të dënuar të sëmurë.
- Ri-integrimin nëpërmjet zhvillimit të programeve për rehabilitimin në shoqëri të paraburgosurve dhe të dënuarve në përputhje me standardet evropiane, ku parashikohen të ri integrohen rreth 360 të dënuar burra, 2 të dënuara gra dhe 6 të dënuar të mitur.
- Ekzekutimin me efektivitet dhe brenda afateve ligjore të titujve të përmbartimit gjyqësor.

B. Reforma administrativo-territoriale

Decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore vazhdon të mbetet një ndër prioritetet e qeverisë dhe reformat e ndërmarra deri më tani pritet të kenë impaktin më të madh në organizimin e administratës publike vendore në funksion të rritjes së cilësisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore.

Reformimi i financave vendore për vitin 2023 fokusohet në rritjen e investimeve, digjitalizimin e operacioneve të menaxhimit financiar në nivel vendor, rritjen e të ardhurave nga taksat vendore si dhe në reformimin e skemave të financimit të qeverisjes vendore, duke u pasqyruar drejtpërsëdrejti në rritjen e transfertës së pakushtëzuar, e cila në krahasim me vitin 2022 është 21.7 miliardë lekë, me një rritje prej 3 miliard lekë. Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2023, do të shtohen edhe fondet prej 9.8 miliardë lekë transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja, duke bërë që në total granti nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor për 2023 të jetë në shumën 31.5 miliardë lekë. Rritja e konsiderueshme e transfertës së pakushtëzuar, tregon rëndësinë që kjo qeveri gjatë këtyre viteve i ka kushtuar procesit të decentralizimit dhe efikasitetit të qeverisjes vendore.

Të ardhurat e veta të pushtetit vendor krahasuar me vitin 2022 janë parashikuar me rritje rreth 1.5 miliardë lekë. Ndërsa, rritja e këtij zëri në krahasim me vitin 2015 është rreth 17.4 miliard lekë. Pjesë e rëndësishme e të ardhurave nga taksat e pushtetit vendor e zënë të ardhurat nga taksa e pasurisë të parashikuara në vlerën 6.9 miliard lekë, të cilat krahasuar me vitin 2022 parashikohen në rritje prej 800 milion lekë.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2023, janë parashikuar në masën 65.5 miliardë lekë, me një rritje prej 8.8% më shumë se buxheti i vitit 2022. Këto shpenzime për vitin 2023, zënë 3% të PBB-së nga 2.3% që zinin në vitin 2013.

Objektiva të tjera të parashikuara në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm janë dhe:

- rritja e pagave për funksionet: arsimi parashkollor, arsimi parauniversitar, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri, administrimi i pyjeve, ujitja dhe kullimi, me një fond prej 340 milion lekë.
- ulja e vazhdueshme e detyrimeve të prapambetura dhe përmirësimi i gjendjes financiare të njësisve të vetëqeverisjes vendore në periudhë afatgjatë, ku nga 12.1 miliardë lekë detyrime në vitin 2016, kjo vlerë në fund të qershorit të 2022 ka rezultuar në 7.1 miliardë lekë.
- vijimi i reformës së taksës së pasurisë duke përfshirë këtu bërjen funksionale të kadastrës fiskale dhe ngritjen e një sistemi të unifikuar të mbledhjes dhe administrimit të taksave vendore.

C. Buxheti i Përgjithshëm Gjnor

Objektiv i vazhdueshëm i Qeverisë i adresuar dhe në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm është dhe buxheti gjnor në sektorë të ndryshëm. Konkretisht, për vitin 2023, 9% e shpenzimeve të përgjithshme për të gjithë sektorët në nivel qendror parashikohet të shkojnë për realizimin e objektivave gjnorë në: arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale, rend publik, bujqësi, drejtësi, etj. Shpenzimet totale për buxhetimin në bazë gjnor arrijnë vlerën 59 miliardë lekë, nga të cilat:

- 27 miliardë lekë për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke rritur financimin e politikës së rishikimit të masës së përfitimit për Ndihmën Ekonomike si dhe politika e mbështetjes së çmimit të energjisë për përfituesit e kategorisë PAK, ku rreth 44% të përfituesve janë gra dhe financimin e skemës së mbështetjes së nënave me 3 (tre) apo më shumë fëmijë të mitur;
- 17 miliardë lekë për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të cilat do të financojnë rritjen e pagave të personeli mësimdhënës në sistemin parauniversitar, etj.
- 9.8 miliardë lekë për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për financimin e politikave të arsimit të mesëm profesional dhe çështjeve të strehimit social.
- 3 miliardë lekë për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të cilat synojnë të rrisin numrin e grave që përfitojnë nga shërbimet e këshillimit dhe informacionit bujqësor dhe nga skemat kombëtare të subvencioneve si dhe nga programi IPARD II.

V. Diskutime në Komision

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2023” u prezantua në Komisionin nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në fjalën e saj, Ministria bëri një përmbledhje të parametrave të përgjithshëm të ekonomisë shqiptare, masave të projektuara për vitin 2023 nga Qeveria për biznesin dhe qytetarët, si dhe një panoramë të përgjithshme të drejtiveve kryesore ku do të fokusohet buxheti vitin e ardhshëm.

Ministrja theksoi faktin se, pavarësisht ndikimit në ekonomi që ka dhe do të ketë situata e luftës në Ukrainë, politikat që do ndiqen në vitin 2023 do materializohen në rritje ekonomike pozitive, rritje të punësimit dhe të tregtisë, si dhe rritje të konsumit dhe investimeve private.

Relatori i këtij projektligji z. Klevis Xhoxhi pasi bëri një ekspozitë të përgjithshme të projektligjit përse i takon përmbushjes së objektivave madhorë të Qeverisë dhe sigurimit të stabilitetit të financave publike, vlerësoi se zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore janë planifikuar në mënyrë rigorozë dhe realiste.

Relatori gjatë fjalës së tij u ndal veçanërisht në:

- mbështetjen e vazhdueshme buxhetore që Qeveria ka akorduar për reformën në drejtësi nëpërmjet të cilës do të rritet besimi i publikut për sistemin e drejtësisë, do të mbështetet zhvillimi i qëndrueshëm social dhe ekonomik i vendit si dhe do të mundësohet integrimin në familjen evropiane;
- reformat e ndërmarra për njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe rritja e konsiderueshme e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, që kanë bërë të mundur që të rriten mbi tre herë investimet dhe shërbimet publike për këto njësi;
- mbajtjen e pandryshuar e çmimit të energjisë elektrike për familjet dhe shumicën e bizneseve, duke alokuar një mbështetje buxhetore prej 12 miliardë lekë për sektorin energjetik përgjatë vitit 2023. Nga viti 2021, buxheti e ka mbështetur me 50 miliardë lekë mbajtjen e çmimit të energjisë të pandryshuar;
- sigurimin e mbështetjes financiare të familjeve me të ardhura më të ulëta, duke rritur pragun e patatueshëm nga 40 mijë lekë në 50 mijë lekë, nga e cila do të përfitojnë mbi 70 mijë të punësuar;
- implementimin e politikave sociale për mbështetjen e veçantë për gratë e papuna me 3 apo më shumë fëmijë deri 18 vjeç, me të ardhura familjare deri në 100 mijë lekë në muaj, duke i mbështetur me pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri 5 vjeç;
- mbështetjen e 1,000 familje te reja, për blerje banese për herë të parë, ku të paktën një anëtar punon në administratë në profesionet e infermierëve dhe punonjësve në fushën e sigurisë.

Anëtarët e Komisionit i drejtuan pyetje të ndryshme si dhe kërkuan informacione të hollësishme nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë lidhur me parashikimet në buxhetin e vitit të ardhëm për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë dhe ish pronarëve, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale dhe sistemin e ndihmës juridike falas që çdo qytetar në pamundësi financiare dhe grupet në nevojë, reformimin e institucioneve të vuajtjes së dënimit, zbatimin e kontratave koncesionare PPP dhe fondet e akorduara në buxhetin e 2023, etj.

Ministrja dhe përfaqësuesit e tjerë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë iu përgjigjën pyetjeve duke shpjeguar se në projektligj janë parashikuar:

- Shpenzimet për Fondin e Kompensimit në vlerë të Pronarëve, në projektbuxhet parashikohen në total në masën 4.5 miliardë lekë ose 0.2% e PBB-së, ndërsa për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1 miliardë lekë ose 0.05% e PBB-së.

- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin 25.95 miliardë lekë ose 1.2% e PBB.
- Shpenzimet për indeksimin e pensioneve është parashikuar niveli prej 1.2 miliardë lekë dhe 3.5 miliardë lekë për bonusin e fundvitit për pensionistët.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në përfundim të diskutimeve vendosi të miratojë në parim projektligjin me 12 vota pro dhe 6 kundër, duke konstatuar se:

- **Në aspektin ligjor**, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi,
- **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Përfaqësuesit e opozitës të pranishëm në mbledhjen e komisionit votuan kundër projektligjit.

Komisioni i Ligjeve, në përputhje me nenet 79 dhe 80 të Rregullores së Kuvendit dhe afateve të përcaktuara Kalendarin e Kuvendit “Për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2023””, ia paraqet këtë raport Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATORË

Klevis XHOXHI

KRYETARE

Klotilda BUSHKA

Saimir HASALLA